



## REPUBLIKAE KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

**Ae.nr.99/2020**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtari Mahir Tutuli, kryetar i kolegjit, gjyqtarëve Liridon Maloku dhe Qerim Ademaj, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të propozuesit të sigurimit ["A..."] sh.p.k, me seli në Prishtinë, të cilin me autorizim e përfaqëson [Q.Z], nga Prishtina, kundër kundërshtarit të sigurimit ["K..."], me seli në Istog, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit, [Sh.Sh], avokat nga Gjilani, lidhur me caktimin e masës së përkohshme të sigurimit, duke vendosur sipas ankesës së kundërshtarit të sigurimit, të paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, IV.EK.C.nr.785/19, të datës 02.03.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me 13.07.2020, mori këtë:

### **A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e kundërshtarit të masës së përkohshme të sigurimit ["K..."], me seli në Istog, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, IV.EK.C.nr.785/19, të datës 02.03.2020, **VËRTETOHET**.

### **A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e atakuar në pikën I të dispozitivit e ka miratuar propozimin e propozuesit të sigurimit ["A..."] sh.p.k, me seli në Prishtinë, për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit ndaj kundërshtarit të sigurimit ["K..."], me seli në Istog, ashtu që në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit është detyruar kundërshtari i sigurimit NTSH ["K..."] me seli në Istog që ta ndërpres menjëherë ritransmetimin e kanalit televiziv "A..." me seli në Republikën e Maqedonisë së Veriut në pakon e saj programe dhe në çfarëdo forme tjetër të ritransmetimit për tere territorin e Republikës së Kosovës, dhe në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit është vendosur që kjo masë siguroese mbetet në fuqi deri në vendimin e ardhshëm gjyqësorë, me të cilin do të ndryshohet apo hiqet kjo masë siguroese.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë kundërshtari i sigurimit ["K..."], me seli në Istog, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit

të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimi i gabuar i të drejtës materiale, me propozimin që Gjykata Apelit ta aprovoj në tërësi ankesën e kundërshtarit të sigurimit, të anulohet aktvendimi IV.EK.C.nr.785/2019 ose të njëjtin ta ndryshojë ashtu që të refuzoje në tërësi propozimin e propozuesit ["A..."] sh.p.k nga Prishtina, si të pabazuar në ligj.

Përgjigje ne ankesë ka parashtruar propozuesi i sigurimit ["A..."] sh.p.k, me seli në Prishtinë, me propozimin që të refuzohet si e pabazuar ankesa e kundërshtarit të sigurimit, të vërtetohet aktvendimi IV.EK.C.nr.785/19, të datës 02.03.2020.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së gjeti se:

#### **Ankesa është e pabazuar.**

Propozuesi "Artmotion" sh.p.k, me seli në Prishtinë me datë 20.12.2019, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, ka paraqitur propozim për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit, kundër kundërshtarit të sigurimit N.SH.T ["K..."], me seli në Istog, me të cilën i ka propozuar gjykatës që të aprovoje propozimin e propozuesit për caktimin e masës së përkohshme i paraqitur kundër propozuesit, dhe të caktohet masa e përkohshme ashtu që të detyrohet kundërshtari i sigurimit që të ndërpresë ritransmetimin e kanalit televiziv "A..." në pakon e saj programore dhe në çfarëdo forme tjetër të ritransmetimit për tërë territorin e Republikës së Kosovës.

Gjykata e shkallës së parë duke vendosur sipas propozimit për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit, me aktvendimin e atakuar, e ka aprovuar propozimin e propozuesit për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë, si të bazuar, duke vlerësuar se janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me Nenin 297 par.1 pikat a) dhe b) të LPK-së.

Gjykata e Apelit e pranon vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK e po ashtu drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore i vështron gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e apelit e mori këtë vlerësim juridik për arsye se sipas Nenit 297.1 nën pikën a) dhe b) të LPK-së parashihet se: "Masa e sigurimit mund të caktohet: a) në qoftë se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij, dhe b) në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtare do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit.

Bazuar në dispozitat e sipërcituara për caktimin e masës së sigurimit duhet të plotësohen kushtet ligjore sipas të cilave propozuesi i sigurimit duhet ta bëjë të besueshme ekzistimin e

kërkesës si dhe ta bëjë të besueshme faktin se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtare do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës së tij. Në rastin konkret nga shkresat e lëndës rezulton se propozuesi i sigurimit në këtë fazë të procedurës, ka ofruar prova lidhur me besueshmërinë e kërkesës së tij, me të cilat vërtetohen pretendimet e tij lidhur me propozimin për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë.

Po ashtu në rastin konkret plotësohet edhe kushti i dytë ligjor për caktimin e masës së sigurimit sepse propozuesi i masës së sigurimit ka ofruar prova të mjaftueshme se pa caktimin e masës së sigurisë pala kundërshtare do të ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit.

Kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejtë dhe ka gjetur se propozimi është i bazuar, ka mbështetje ligjore si dhe janë dhënë arsyet e justifikueshme të bazuara në shkresat e lëndës, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Gjykata i vlerësoi pretendimet ankimore të kundërshtarit të sigurimit por gjeti se të njëjtat nuk përbëjnë arsye që kanë mbështetje ligjore, e për të cilat duhet prishur aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktvendimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, sepse e njëjta me të drejtë nga vlerësimi i provave që gjenden në shkresat e lëndës ka gjetur se janë përmbushur konditat ligjore të parapara me dispozitën e nenit 297.1 nën pikën a) dhe b) të LPK-së, për caktimin e masës së sigurisë.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 208, nenit 209, al.1 pika b) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS,**  
**Ae.nr.99/2020, dt.13.07.2020**

**KRYETARI I KOLEGJIT,**  
**Mahir Tutuli, d.v.**  
